

SPECIFIKIME TEKNIKE

Objekti: RIKONSTRUKSION I URES SE PROGRIT, DEVOLL

I. PUNIMET E PRISHJES

1. Per heqjen e elementeve te vjeter (traret) me perpara gjenden ganxhat e montimit, priten pllakat e hekurave qe bashkojne elementet njeri me tjetrin me drogo ose saldatrice. Per heqjen e elementeve duhet te porositen vinca me aftesi ngritje mbi 12.5 Ton, duke qene se elementet e mesit peshojne mbi 10 Ton.
2. Pasi patrohen jasteket e mbeshtetje nga mbeturinat por dhe nga betoni I demtuar, shenohen cdo 10 cm vrima me trapan me diameter >16 mm. ne keto vrima vendosen hekurat sic percaktohen ne project dhe behet kallepi per hedhjen e betonit.
3. Betoni I Jastekut prodhohet I markes C-20/30. Per sasine qe duhet eshte I kushtezuar te prodhohet prane objektit. Per kete duhet material cilesor mbushes dhe cimento M.500 nga e cila do hidhet 370 kg/m³ beton.
4. Prodhimi I elementeve te rinj do te filloje ne Kohen qe fillon prishja (heqja e elementeve te vjeter). Per kete te merren masa per porositjen e prodhimit ne Elbasan, ne te kundert te krijohet sheshi per prodhimin prane objektit. Betoni I elementeve do te prodhohet ne nyje prodhimi te licensuara qe perdorin materiale te pastra. Betoni do te porositet M 300 kg/cm².
5. Montimi I elementeve do te behet 30 dite nga data e prodhimit qe te arrijme stazhionimin e betonit. Elementet kane nje peshe te konsiderueshme prej mbi 18 Ton dhe do te kerkoje vinca me kapacitet mbi 20 Ton duke patur parasysh qe biga e vincit do te shtrihet ne gjysmen e hapesires prej 11.4 m.
6. Betonimi I bazamentit te nje mbeshtetjeje qe eshte demtuar do behet pasi te jete pastruar betoni I demtuar. Kjo do te realizohet duke devijuar ijin e lumit dhe do te behet para se te montojne elementet e rinj, me formen si ne vizatim.
7. Parapeti I ures do behet pasi te jene montuar 2 elementet. Eshte mire qe kollonat vertikale t'I realizojme me kallep ne vend, ndersa segmentet

horizontale t'i pergatitim ne shesh dhe te bejme montimin duke l salduar, pasi kerkojne shume kallep per t'u realizuar ne objekt.

8. Shtresa e binderit do te hidhet pasi te pastrohet pjesa e siperme e ures dhe te sperkatet me bitum te lengshem ose prajmer. Duhet patur parasysh qe lidhja me asfaltin e hapësirave ngjitur duhet te behet duke e prere me pare asfaltin.
9. Asfaltobetoni hidhet ne kohen pa u shkelur nga mjetet binderi. Ne te kundert pastrohet e lyhet me prajmer para shtreses.

Ing. Spiro Dama
Drejtues teknik i Studios "Arbi" shpk

